



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIU



Ë-buletin

Korrik, 2020

Një aktivitet i SBASHK-ut i vlerësuar lart nga anëtarësia **Kishte nga ata që për të parën herë po shihnin bukuritë e detit**



U gjallërua atmosfera në Kompleksin Hotelier “Bonita” më 6 korrik. Punëtorët e arsimit të përzgjedhur prej kolegëve të tyre nga Vushtrria, Mitrovica, Leposaviqi, Zveçani, Skenderaj, Prizreni, Kaçaniku, Hani i Elezit, Ferizaj, Shterpca, Shtime, Suhareka, Klina, Istogu, Peja, Deçani e Juniku po shënonin fillimin e traditës së mirë të SBASHK-ut për organizimin e pushimeve në bregdetin shqiptar. Ata vlerësuan lart organizimin e shkëlqyer të këtij aktiviteti dhe mikpritjen e ... (faqe 4)

SBASHK vazhdon angazhimet për të gjetur zgjidhje të pranueshme

Kolegët tanë të sëmurë rënd meritajnë përkujdesjen e institucioneve

Ka kohë që SBASHK-u në çdo takim me institucionet ka ngritur çështjen e kolegëve tanë që janë goditur ... (faqe 8)

Intervistë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Kemi punuar shumë në shërbim të anëtarësisë, kështu do të vazhdojmë



Në situatën kur në Kosovë, sikur në ... (faqe 3)


SBASHK dhe sindikatat tjera në takim me Kryeministrin Hoti
Çka pas vendimit të Kushtetueses lidhur me Ligjin e pagave?



Gjykata Kushtetuese e Kosovës pas dy pezullimeve me nga tre muaj të Ligjit të Pagave solli më ... (faqe 7)

Komunikim i vazhdueshëm i sindikatave nga Evropa e bota

SBASHK pjesë aktive e këtij angazhimi në shërbim të arsimit



Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) dhe Internacionalja Botërore e ... (faqe 6)



Editorial

Ndjehesh mirë dhe krenar



Pjesa e dytë e vitit shkollor 2019/2020 ishte me plot sfida. Arsimit në Kosovë dhe në gjithë botën ishte para një sfide të veçantë. Në kuadër të masave ndaj Covid 19 shtetet u detyruan të mbyllnin institucionet arsimore, por rrugëtimi drejt diturive të reja nuk bën të ndalej. U nis me 13 mars një rrugëtim i ri për dije. Punëtorët arsimit, nxënësit dhe prindërit betejën për dije po e vazhdonin me një formë të pa përdorur më parë. Me platforma e me mësimin në RTK duhej zhvilluar betejën për të marrë sa më shumë njohuri. Ata që nuk e duan Kosovën e as arsimin në vendin tonë filluan t'i fërkonin duart duke menduar e u erdhi momenti për të kritikuar e për të zbrazur vrerin me shpresë se punëtorët e arsimit nuk do të gjenden dot në situatën e re e në përcjellje të dijes e në mbajtje të komunikimit me platformat. U mobilizua SBASHK-u dhe nisi

të mbante takime me gjithë anëtarësinë duke u dhënë mbështetje e duke i përgëzuar për punën e përkushtimin. SBASHK-u mbajti komunikim të vazhdueshëm edhe me MASHTI-n në shërbim të arsimit dhe në Kosovë e kudo në botë punëtorët e arsimit u treguan edhe një herë. Rrugëtimi drejt njohurive të reja nuk u ndal. Punëtorët e arsimit nga Evropa dhe e tërë bota ishin bashkë dhe bartnin ide e përvoja duke mbështetur njëri-tjetrin.

Punëtorët e arsimit edhe kësaj radhe mbrojtën dhe lartësuan figurën e mësuesit . Ju lumtë! Duke parë gjithë këto angazhime e përkushtim ndjehesh mirë dhe krenar.

SBASHK duke shprehur respektin dhe krenarinë për anëtarësinë dërgoi në mënyrë të organizuar një numër të konsideruar anëtarësh për pushime në bregdetin shqiptar. Ata gjatë gjithë qëndrimit në bregdetin shqiptar treguan qëndrim dinjitoz dhe në një atmosferë të mrekullueshme pushimi e buzë valëve të detit shqiptar bashkëbiseduan për arsimin, përkushtimin, sfidat dhe shprehen respekt të lartë për sindikatën e tyre. Duke qenë pjesë e gjithë asaj atmosfere, gjallërinë, të cilës ia shtoi edhe Ansambli Autokton “Rugova” njeriu ndjehet mirë dhe krenar.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Kemi punuar shumë në shërbim të anëtarësisë, kështu do të vazhdojmë



Në situatën kur në Kosovë, sikur në gjithë botën, mësimi u zhvillua nga larg për shkak të pandemisë, SBASHK-u orientoi një pjesë të madhe të angazhimit në shërbim të këtij procesi,

që nuk ishte edhe i lehtë. Krahas kësaj SBASHK-u zhvilloi edhe shumë aktivitete në shërbim të anëtarësisë. Për këto dhe për sfidat që presin sindikatën dhe arsimin në tërësi zhvilluam këtë intervistë me kryetarin Jasharaj.

Arsimimi sot:

Kryetar e kishit thënë fillimisht se 2019-ta ishte vit i vështirë e plot sfida , por të vështirë e keni vlerësuar e vitin shkollor që u përfundua me sukses.

Jasharaj:

Po ashtu është. Viti 2019 ishte i vështirë e plot sfida. Kishim grevën tre javore , që u vlerësua si shumë unike dhe doli të jetë e suksesshme sepse u arrit të përmirësoheshin dukshëm koeficientet për tërë sistemin arsimor. Sfidat nuk u hoqën sepse kishte presione për zëvendësimin e orëve të humbura në grevë, por u dëshmuar edhe një herë uniteti e organizimi i shkëlqyer sindikal i SBASHK nga çerdhet, Arsimi Parauniversitar dhe në Universitete dhe ruajt forca e grevës si veprim sindikal. Kishim uruar që vitet në vijim të mos jenë të vështira si 2019-ta, por nuk doli ashtu. Një armik i keq e i padukshëm kaploi tërë botën dhe bëri që shumë fragmente të jetës të ndryshojnë. Nga 13 marsi as sistemi arsimor nuk ishte ai i janarit e shkurtit. Shkollat u mbyllën dhe duhej bërë një rrugëtim ndryshe drejt diturive të reja. Duhej nisur me mësimin nga larg dhe kjo nisje krijoi arsyeshëm edhe sfida. SBASHK-u, si gjithmonë, edhe tani, u angazhua shumë në shërbim të arsimit duke mobilizuar anëtarësinë e duke mbajtur takime në vazhdimësi me veprimtarë e me anëtarë të sindikatës për të bërë bashkë forcën e dijen në shërbim të

rrjedhës së mbarë të mësimit nga larg. Punëtorët e arsimit në Kosovë u dëshmuar edhe një herë dhe prandaj viti i kaluar mësimor përfundoi me sukses.

Arsimimi sot:

Edh në këtë situatë SBASHK-u , krahas angazhimeve sindikale shënoi arritje të larta edhe në shërbim të arsimit dhe ngritjes së vazhdueshme të cilësisë.

Jasharaj:

Po. Gjatë gjithë kësaj kohe stafi qendror i SBASHK-ut bashkë me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve dhe me Këshillin Drejtues ishin në komunikim të vazhdueshëm duke dhënë kontribut të lartë në organizimin sa më të mirë të mësimit nga larg. Po ashtu mbahej komunikim i rregullt edhe me MASHTI-n dhe ata kanë përgëzuar SBASHK-un për angazhimin dhe kontributin e dhënë për rrjedhën e mbarë të mësimit nga larg. SBASHK-u , krahas kësaj , vazhdoi edhe me angazhime sindikale dhe me veprime konkrete në shërbim të anëtarësisë. Duke falënderuar angazhimin e përkushtimin e koordinatorëve të trajnimeve Ymer Ymeri e Vjollca Shala dhe të stafit qendror u arrit një sukses i jashtëzakonshëm në organizimin e mirë të trajnimeve të licencuara. Mijëra punëtorë të arsimit kishin shprehur dëshirën që të jenë pjesë e trajnimeve të organizuara përmes platformës gjegjëse dhe ky aktivitet është vlerësuar lart. SBASHK-u për këtë arritje falënderon edhe trajnerët , të cilët ishin të përkushtuar dhe ndihmuan ë trajnimet të kenë rrjedhë të mbarë dhe të përfundojnë suksesshëm.

Arsimimi sot:

SBASHK-u zhvilloi edhe shumë aktivitete të tjera në shërbim të anëtarësisë, por ju a do ta veçonit ndonjërin prej tyre ?

Jasharaj:

Po janë zhvilluar edhe shumë aktivitete të tjera e angazhime në shërbim të anëtarësisë. Jemi angazhuar të krijohet një zgjidhje e pranueshme ligjore për kolegët tanë të sëmurë rëndë, angazhohemi që të

zgjidhet drejt çështja e kolegëve tanë që janë në sistemin arsimor e që kanë 180 kredi. Këtyre duhet MASHTI t'u krijojë mundësi që pa shkëputje nga puna të vazhdojnë me programin gjegjës të studimeve ashtu si u veprua me kolegët tanë që dikur kishin SHLP-në.

Nga angazhimet do ta veçoja mbase vazhdimin e traditës së mirë, edhe pse në rrethana e kushte të vështirësuar, të dërgimit të një numri të konsideruar të anëtarëve tanë në bregdetin shqiptar. Kjo traditë u realizua me shumë sukses edhe në verën e vitit 2020 falë angazhimit të komisionit përgatitor, që udhëhiqej nga Ymer Ymeri, e që u ndihmua nga i gjithë stafi qendror i SBASHK-ut, nga kryetarët e nivelit komunal e të Universiteteve, nga udhëheqës të autobusëve dhe nga përgjegjësit e caktuar për mirëvajtjen e pushimeve. Unë nuk do të flas më shumë për rrjedhën e pushimeve sepse këtë e kanë shprehur me kujtimet e tyre shumë nga pushuesit dhe këto i ruajmë në fletoret

e përshtypjeve dhe besoj se një pjesë e tyre edhe do të botohen në gazetën "Arsimimi sot".

Arsimimi sot:

Çka tutje ?

Jasharaj:

SBASHK-u gjithmonë është angazhuar në realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe në shërbim të arsimit. Gjithmonë kemi vepruar në bazë të kërkesave të anëtarësisë dhe jemi e do të mbetemi zëri i tyre. Para fillimit të vitit të ri shkollor Këshilli Drejtues, Kryesia, kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve do të kenë takime për të analizuar situatën aktuale e për të caktuar detyra konkrete. Pastaj bashkërisht do të angazhohemi për realizimin e këtyre detyrave dhe bazuar në unitetin e lartë sindikal dhe gatishmërinë e të gjithëve për punë e angazhime besoj shumë se do ia dalim në realizimin të gjitha detyrave në shërbim të anëtarësisë.

Gjatë muajit

Një aktivitet i SBASHK-ut i vlerësuar lart nga anëtarësia

Kishte nga ata që për të parën herë po shihnin bukuritë e detit



U gjallërua atmosfera në Kompleksin Hotelier "Bonita" më 6 korrik. Punëtorët e arsimit të përzgjedhur prej kolegëve të tyre nga Vushtrria, Mitrovica, Leposaviqi, Zveçani, Skenderaj, Prizreni, Kaçaniku, Hani i Elezit, Ferizaj, Shterpeca, Shtime, Suhareka, Klina, Istogu, Peja, Deçani e Juniku po shënonin fillimin e traditës së mirë të SBASHK-ut për organizimin e pushimeve në bregdetin shqiptar. Ata vlerësuan lart organizimin e shkëlqyer të këtij aktiviteti dhe mikpritjen e Astritit dhe stafit të "Bonita". Një vlerësim të tillë kanë bërë edhe kolegët tanë pushues në grupin e dytë që po vinin nga Lipjani, Kastrioti (Obiliqi), Biblioteka Kombëtare, Qendra e Studentëve, Fushë Kosova, Drenasi, Podujeva,

Prishtina, Universitetet, Kamenica, Gjilani, Vitia, Kllokoti, Dragashi, Malisheva, Rahoveci, Gjakova dhe Mamusha.

Ata u çlodhën pranë valëve të detit shqiptar dhe në atmosferën festive që krijohej çdo mbrëmje përmes humorit të lehtë dhe këngës e valles së bukur shqipe. Përshtypje të paharruara ata ruajnë nga një mbrëmje dhe atmosfera e krijuar me pjesëmarrjen e Ansambllit Autokton "Rugova".



"Respekt për SBASHK-un që organizoi këtë aktivitet. Po ndjem shumë mirë këtu se u takova me shumë



kolegë nga gati e tërë Kosova. Unë për të parën herë jam në këtë ambient kaq të bukur. Angazhimi i përgjegjësve, mikpritja, atmosfera që po krijohet nga humori i lehtë dhe nga kënga e vallja janë momente që do t'i kujtoj gjatë gjithë jetës”, flet njëri nga pushuesit dhe nga shumë të tjerë pohohej kjo.

Përgjegjësit e këtij aktiviteti ndjeheshin mirë nga këto biseda dhe vazhdonin me përkushtimin. Pushuesit të kënaqur me gjithë këtë atmosferë ndaleshin e bisedonin nga afër me kryetarin dhe me anëtarë të tjerë nga stafi i SBASHK-ut dhe bënë edhe foto për t'i mbajtur si kujtim nga këto ditë buzë detit shqiptar.



“Kam menduar se do të mërzitem për një ditë dy, por jo qe besa. Këtu është shumë mirë. Kujdesi, respekti, ushqimi, deti, muzika të bëjnë të ndihesh mirë. Qe besa kryetari do të ishte mirë të na vazhdonte pushimin edhe për ndonjë ditë “, u thoshte një pushues shokëve të tij me zë pak më të lartë sikur donte që kërkesën e tij ta dëgjonte edhe kryetari i SBASHK-ut.

“Po më vjen shumë mirë që po ndiheni kaq të relaksuar e mirë këtu. Unë ju përgëzoj për sjelljet dhe



atmosferën që po krijoni. Ju po përfaqësoni në mënyrë të denjë figurën e punëtorëve të arsimit të Kosovës”, foli kryetari Jasharaj dhe pastaj vazhdoi të fotografohej me shumë nga pushuesit.

Bashkëbiseda e fotografi të përbashkëta po bëheshin edhe gjatë gjithë ditëve të tjera.




Pushuesit kanë lënë vlerësimet e mendimet e tyre edhe në fletoret e përshtypjeve. E përbashkëta e tyre është falënderimi e respekti për stafin e SBASHK-ut, që janë angazhuar maksimalisht që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë. Aty flitet me fjalë të zgjedhura e plot respekt për kryetarin Jasharaj, për Ymerin, Vjollcën, Blendorin, Nezafeten, Albinën, Afërditën, Vlorën dhe për përgjegjësit e udhëtimit Gyltenen, Blerinën, Ahmetin, Emrushin, Veliun, Blerimin. Respekti e krenaria është e përbashkët.



Komunikim i vazhdueshëm i sindikatave nga Evropa e bota

SBASHK pjesë aktive e këtij angazhimi në shërbim të arsimit

Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) dhe Internacionalja Botërore e Arsimit (EI) në vazhdimësi kanë organizuar takime, tryeza e aktivitete me sindikatat anëtare me qëllim të analizës së situatës në arsim dhe të bartjes së përvojave të mira të aktivitetit sindikal dhe në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim. Në të kaluarën këto aktivitete janë zhvilluar duke u takuar përfaqësuesit sindikal në Bruksel, në selinë e ETUCE apo të EI-së, por situata e re krijuar nga Covid-19 ka bërë që këto aktivitete të zhvillohen përmes takimeve nga larg.




Në të gjitha këto takime është bërë një analizë e situatës ekzistuese në arsim dhe janë dhënë ide e mendime se si duhet vepruar në situatat aktuale, që nuk janë të lehta dhe që kërkojnë angazhime e përkushtim të shtuar. Pjesë e këtyre takimeve kanë qenë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, të cilët kanë informuar për gjendjen aktuale në arsim, për sfidat,

Gjendja aktuale në Kosovë e krijuar nga Covid-19 aktualizon arsyeshëm pyetjen

Si do të nis viti i ri shkollor ?

Gjendja aktuale në Kosovë e krijuar nga Covid-19 po vlerësohet si e rënduar dhe institucionet kanë ndërmarrë edhe masa shtesë. Në gjithë këtë situatë aktualizohet arsyeshëm pyetja se si do të nis viti i ri shkollor. Dikush do të thoshte se është edhe plot një muaj deri te shtatori, por koha ik shpejt. MASHTI ka bërë angazhimet e para dhe ka krijuar një

por edhe për angazhimin e përkushtimin e punëtorëve arsimor në rrjedhën sa më të mbarë të mësimin nga larg. Ata kanë informuar edhe për komunikimin e vazhdueshëm me anëtarësisë dhe për mobilizimin për arritje sa më të larta dhe për aktivitetet e shumta sindikale. Udhëheqësit e ETUCE dhe të EI-së kanë përgëzuar sindikatat anëtare për angazhimet në situatën e re e të rënduar dhe kanë apeluar vazhdimisht për përkushtim dhe solidaritet mes punëtorëve të arsimit kudo në Evropë e botë.



EI dhe ETUCE do të vazhdojnë me angazhimet dhe komunikimin me sindikatat anëtare e po ashtu edhe SBASHK-u do të vazhdojë të jetë pjesë e këtyre aktiviteteve me qëllim që të 11 milionë punëtorët e arsimit, sa janë anëtarë në ETUCE dhe të 32 milionë mësimdhënësit nga e tërë bota si anëtarë të Internacionales Botërore të Arsimit të jenë në frontin e përbashkët për rrugëtimin drejt diturive të reja dhe të përpjekjeve për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë



Në të gjithë takimet e shumta me veprimtarët dhe anëtarët e sindikatës sonë jemi lutur që angazhimet e radhës t'i kryejmë në institucionet arsimore, por situata si kjo tani mund ta bëjë të pamundur kthimin në institucionet arsimore dhe se

duhet vazhduar të punohet me platformat e me realizimin e mësimit nga distanca. Nëse ndodh kështu atëherë institucionet qendrore dhe DKA-të duhet të shtojnë angazhimet dhe të bëjnë zgjidhje për çështjet e ngritura nga SBASHK-u pas takimeve të shumta me kolegët tanë kudo në Kosovë. Duhet mbështetur punëtorët e arsimit dhe familjet me gjendje më të rënd sociale në mënyrë që të gjithë të jenë pjesë e mësimit nga larg. Qeveria duhet të shoh mundësitë edhe për një përkrahje shtesë materiale për punëtorët e arsimit sepse nga ta mësimi nga larg kërkon angazhim me orar të stërzgjatur. Cili do që të jetë 1 shtatori, SBASHK-u do të jetë në krye të detyrës e në angazhimet në shërbim të arsimit dhe realizimit të kërkesave të anëtarësisë.

SBASHK dhe sindikatat tjera në takim me Kryeministrin Hoti

Çka pas vendimit të Kushtetueses lidhur me Ligjin e pagave?

Gjykata Kushtetuese e Kosovës pas dy pezullimeve me nga tre muaj të Ligjit të Pagave solli më 30 qershor një vendim, që me arsye shqetësoi të punësuarit në sektorin publik dhe krijoi atmosferë të tensionuar. Duke u gjendur në këtë situatë Kryeministri Hoti ftoi në një takim SBASHK-un dhe pesë sindikata të tjera, që janë përfaqësues të shumicës së të punësuarve në sektorin publik. Takimi u mbajt në sallën e madhe në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës dhe Kryeministri Hoti po shoqërohej nga zëvendëskryeministri Driton Selmanaj.



Kryeministri Hoti u ka thënë përfaqësuesve të gjashtë sindikatave se e kupton shqetësimin e tyre dhe se Qeveria do të angazhohet maksimalisht që në kohën sa më të shpejt të analizohen vërejtjet e Kushtetueses, të

përmirësohen lëshimet dhe të procedohet Ligji për aprovim dhe pastaj edhe për implementim.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka falënderuar Kryeministrin Hoti dhe zv/kryeministrin Selmanaj për pritjen dhe pastaj ka shprehur shqetësimin për veprimin e Kushtetueses duke alarmuar se në situatën e re, shtatori mund të fillojë me veprime sindikale dhe se SBASHK do të veprojë sipas zërit të anëtarësisë. Ai ka kërkuar që Qeveria deri në kohën kur do të nis së implementuari Ligji i pagave të gjejë mundësi për të dhënë shtesë brenda mundësive buxhetore për punëtorët e arsimit dhe të punësuarit e tjerë të sektorin publik.

Edhe përfaqësuesit e Sindikatës së Shëndetësisë, Policisë, Zjarrfikësve, Administratës dhe Doganës kanë përcjellë në këtë takim situatën e krijuar në sektorët që përfaqësojnë duke deklaruar se mund të ketë veprime sindikale edhe në këta sektorë.

Kryeministri Hoti ka deklaruar se do të vazhdojnë takimet dhe komunikimin me sindikatat dhe se shumë shpejt do të nis punë nëpër komisione lidhur me Ligjin e pagave.

SBASHK vazhdon angazhimet për të gjetur zgjidhje të pranueshme

Kolegët tanë të sëmurë rënd meritojnë përkujdesjen e institucioneve

Ka kohë që SBASHK-u në çdo takim me institucionet ka ngritur çështjen e kolegëve tanë që janë goditur nga sëmundje të rënda, por që në mungesë të një zgjidhjeje të pranueshme, detyrohen të shkojnë në punë. SBASHK-u vazhdon me angazhimet në përpjekjet në shërbim të këtyre njerëzve, teksa të tjerët e thonë se është angazhim i qëlluar, por mbesin me kaq.



SBASHK-u në takimet me përfaqësues të institucioneve, por edhe në tryeza e Konferenca të organizuara ka ofruar ide e mundësi reale për këtë çështje dhe të gjithë ishin shprehur se kjo është e mundur duke falënderuar pastaj SBASHK-un për përkushtimin e sinqertë. Ide lehtë e realizueshme është kjo e SBASHK-ut vetëm se duhet vullnet dhe sinqeritet i institucioneve.

Cila është ideja e SBASHK-ut ?

Kolegët tanë që i ka goditur sëmundja e rëndë dhe që vështirë po e kanë të shkojnë në punë, të lirohen nga procesi mësimor dhe deri sa nuk e arrijnë moshën e pensionimit të marrin 75 % të pagës që kanë, ndërsa 25% të vlerës së asaj page ta marrin të angazhuarit që kanë kryer fakultetin gjegjës dhe që do të nisnin me fazën hyrëse në arsim.

Ky propozim i menduar mirë i SBASHK-ut ua hoq nga tavolina institucioneve atë deklarinimin se nuk ka mjete e buxhet dhe ua hapi mundësinë që të veprojnë e të krijojnë infrastrukturë ligjore për këtë kategori njerëzish që me dekada kanë punuar në arsimim, por që tani janë goditur nga sëmundja. Këta njerëz meritojnë përkujdesje dhe lirimi i tyre nga procesi mësimor do të ishte në shërbim të ngritjes së cilësisë, por do të ishte edhe veprim human i institucioneve. Kjo është e mundur dhe mund të bëhet, por vetëm kërkohet që institucionet të kalojnë nga fjalët në vepra duke krijuar një bazë ligjore për këta njerëz që me arsye presin mbështetjen e shtetit. Ata nuk e zgjodhën dhe nuk e duan gjendjen në të cilën janë. Sëmundja mund ta prek këdo dhe prandaj duhet ta dëshmojmë humanitetin tonë.